



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1917 Prot

Roskovec, më 28.04 2020

VENDIM

NR 29 .DATË 27.04 .2020

“PËR KRIJIMIN E MUZEUT VENDOR NË BASHKINË ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 25, pika 1 dhe neni 54, gërma k); Ligji Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 214, pika 2. Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Krijimin e Muzeut Vendor në Bashkinë Roskovec.
2. Miratohet që Muzeu Vendor të funksionojë në objektin e Godinës së Bashkisë Roskovec, regjistruar me Vërtetim Hipotekor nr. 527 datë 22.09.2003 dhe adresë, qendra e qytetit Roskovec.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria Juridike me procedurat e ndryshimit të fushës së përdorimit sipas legjislacionit në fuqi dhe miratimit të tij në Këshillin Kombëtar të Muzeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

